

# RELACION

## PËR

### PROJEKTLIGJIN

#### “PËR BLETARINË”

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i projektaktit është të njohë bletarinë si veprimtari me interes jetësor, kombëtar, e dobishme për ruajtjen e mjedisit natyror, ekosistemit dhe bujqësisë në përgjithësi dhe që synon garantimin e pjalmimit natyror dhe biodiversitetit të llojeve të bletëve, me referencë të veçantë për mbrojtjen e racës së bletës (*Apis mellifera carnica*) dhe popullata tipike vendase të bletëve ose zonave kufitare. Objekti i këtij projektakti është përcaktimi i rregullave për prodhimin, regjistrimin, transportin, riprodhimin, mbrojtjen, etiketimin, përpunimin dhe ruajtjen e produkteve të bletarisë, si dhe për kontrollin e cilësisë dhe gjurmueshmërinë e këtyre produkteve sipas programeve 3-vjeçare. Gjithashtu mbështetja e Sektorit të Bletarisë në funksion të promovimit dhe mbrojtjes së produkteve shqiptare të bletarisë si dhe nxitja e proceseve të gjurmueshmërisë sipas legjislacionit përkatës, për mbrojtjen e mjaltit shqiptar.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektakti është parashikuar në Programin Analitik të Akteve që do të miratohen për vitin 2022. Projektakti nuk bazohet në ndonjë angazhim konkret të Programin Politik të Këshillit të Ministrave por është në përputhje me objektivin e Qeverisë së Shqipërisë, për rritje të konkurrueshmërisë së produkteve, rritje të cilësisë, të esporteve, drejt përmbushjes së kriterëve për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE, duke synuar përafrimin e plotë të legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Evropian, të paraqitur në nivel kombëtar në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian.

Gjithashtu projektakti është i lidhur me: Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 709, datë 29.10.2014 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020”; draft-strategjinë “Për bujqësinë, zhvillimin rural dhe peshkimin 2021-2027; Strategjinë e Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut 2020, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 753, datë 16.9.2015, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2015-2020”.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Bletaria është sektor i rëndësishëm i bujqësisë së vendit që shërben si burim prodhimesh natyrale me vlerë të lartë ushqimore dhe mjekësore. Përmes pjalmimit ose polenizimit ndikon në rritjen e prodhimit të shumë kulturave bujqësore, ndikon në mbajtjen e florës së pyjeve dhe kullotave duke ripërtërirë natyrën si hallkë e zinxhirit ekologjik, mbështet dhe ofron shërbime të tjera, të tilla, si: apiturizmi (turizmi i bletëve), apiterapia (përdorimi mjekësor i produkteve nga bletët) dhe monitorimi i ndotjes së mjedisit.

Nisur nga kjo rëndësi, kërkesat për përafrimin me legjislacionin e BE-së si dhe bazuar në faktin që nuk ka legjislacion të veçantë për këtë veprimtari, është i domosdoshëm hartimi i një ligji për bletarinë.

Përafrimi rregulloreve të BE-së, mungesa e një legjislacioni të vetëm për CMO (Organizimi i Tregut të Përbashkët), pjesë e së cilës është dhe bletaria, bën të domosdoshme hartimin e një ligji të ri.

Bletaria karakterizohet nga shumëllojshmëria e kushteve dhe rendimenteve të prodhimit dhe shpërndarja dhe shumëllojshmëria e operatorëve ekonomikë, si në fazën e prodhimit ashtu edhe në atë të tregtimit. Për të përmirësuar prodhimin dhe tregtimin e produkteve të bletarisë, si dhe duke pasur parasysh rritjen e incidencës në shëndetin e bletëve të llojeve të caktuara të pushtimeve të koshereve, dhe në veçanti të përhapjes së varrozës në vende të ndryshme të BE-së dhe jo vetëm, vitet e fundit dhe problemeve që kjo sëmundje shkakton në prodhimin e mjaltit, lind nevoja e trajtimit dhe kontrollit.

Efektet e pritshme të projektaktit së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij konsistojnë në rritjen e përgjegjësisë së subjekteve që zhvillojnë aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të produkteve të bletarisë si rezultat i kontrollit gjatë të gjithë zinxhirit ushqimor, pasi një ushqim i sigurt garanton një jetë të shëndetshme e për rrjedhojë shpenzimet për kujdesin shëndetësor do të reduktohen. Edhe për konsumatorin një efekt i pritshëm i drejtpërdrejtë është blerja e produkteve të bletarisë më të sigurta, më cilësore dhe shkallë më të lartë gjurmueshmërie për to.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektakti është në përputhje me nenet 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE**

Ky projektakt ka përafrim me legjislacionin e BE-së përkatësisht me Rregulloren BE: Nr. 1308/2013, datë 17 dhjetor 2013, “Për Organizimin e Tregut të Përbashkët”, si dhe Direktiva e Këshillit Nr. 2001/110/EC e datës 20 dhjetor 2001 në lidhje me mjaltin, e ndryshuar.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Ky projektligj është hartuar me 10 krerë dhe i përbërë nga 33 nene, me përmbajtje si më poshtë:

***Kreu I, “Kushte të Përgjithshme”, përbëhet nga 7 nene (përkatësisht nga neni 1 – neni 7), dhe pasqyrohen:***

Qëllimi i projektaktit i cili është të njohë bletarinë si veprimtari me interes jetësor, kombëtar, e dobishme për ruajtjen e mjedisit natyror, ekosistemit dhe bujqësisë në përgjithësi dhe që synon garantimin e pjalmimit natyror dhe biodiversitetit të llojeve të bletëve, me referencë të veçantë për mbrojtjen e racës së bletës (*Apis mellifera carnica*) dhe popullata tipike vendase të bletëve ose zonave kufitare; përkufizimet e

të gjithë termave të përdorura në kuptim të këtij ligji; fusha e zbatimit e cila është në të gjithë parqet e bletëve nga bletarët të cilët janë persona fizikë ose juridikë dhe zotërojnë zgjoje dhe pajisje të nevojshme për zhvillimin e kësaj veprimtarie, sipas dispozitave të këtij ligji dhe rëndësia e sektorit të bletarisë; Cilat janë produktet e bletarisë të cilat konsiderohen të tilla sipas këtij projektligji; Regjistrimi në regjistër, kushtet dhe procedurat që duhen ndjekur, institucionet, afatet, mënyra e mbajtjes së regjistrit dhe aksesimi; vendndodhja e parkut të bletëve kufijte që duhen respektuar, të dhënat mbi vendosjen e parkut të bletëve, distancat, afërsia me struktura të prodhimit, përpunimit apo zonave të ndotura, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrisë me bashkitë përkatëse. Ndalimet e aktivitete të ndryshme prodhuese industriale në afërsi të parqeve të cilat ndikojnë në dëmtimin e bletëve.

***Kreun II, “Lëvizja dhe Transporti i Bletëve”, përbëhet nga 2 nene (neni 8 dhe 9) dhe përcakton që:***

Shtegtimin e bletëve nga një vend në një vend tjetër për të shfrytëzuar kullotën dhe për të nxitur prodhimin e llojeve të ndryshme të mjaltit njëlulësh, pjalmimin e kulturave bujqësore, apo shmangien e kushteve të pafavorshme klimatike, procedura e paraqitjes së kërkesës për shtegtimin, dokumentacioni, institucioni që duhet të drejtohen dhe afatet; transporti i zgjojeve mund të bëhet me të gjitha mjetet e transportit me kushtin që të jenë të mbyllura për të penguar fluturimin e bletëve gjatë transportit, kushtet e mjeteve që do kryejnë transportin, veshjet, mjetet mbrojtëse dhe kohëzgjatja.

***Kreun III, “Riprodhimi i Bletëve, Kullotat”, përbëhet nga 2 nene (neni 10 dhe 11) dhe përcakton që:***

Riprodhimi i bletëve, për përzgjedhjen e bletëve duhet të përdoret lloji i bletës Evropiane *Apis Mellifera* dhe nënlojet lokale të bletëve, bletari duhet të ketë në konsideratë përshtatjen e llojit me kushtet lokale klimatike dhe rezistencën ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve të tjerë. Importimi i mbretëreshave nga vendet e tjera duhet të kontrollohet nga Ministria dhe të jetë i shoqëruar me dokumentacionin përkatës, sipas përcaktimeve ligjore dhe do të bëhet vetëm për subjektet e autorizuara nga AKVMB-ja.

Qendrat riprodhuese për mbretëresha të bletëve, riprodhimi dhe tregtimi janë të përcaktuara në legjislacionin përkatës “Për mbarëshkrimin e blegtorisë”. Prodhimet si nektari, mjalti, poleni dhe propolisi janë prodhime të një cikli natyror me interes publik dhe për qëllime të një shfrytëzimi të përshtatshëm të prodhimit të nektarit, nxitet mbarëshkrimi i bletëve dhe praktika ekonomiko-prodhuese e shtegimit.

Vendndodhja, sipërfaqja, lloji i kullotave, kapaciteti mjaltëdhënës, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, pas përfundimit të studimit për këtë qëllim nga ministria, gjithashtu ministri, bazuar në të dhënat e studimit, miraton për një periudhë 5 (pesë) vjeçare programin e shfrytëzimit të kullotave. Propozimet për administrimin e kullotës mjaltëdhënëse, bëhen nga shoqata lokale e bletërritësve, sipas territorit të caktuar dhe nëse nuk ka një propozim nga kjo e fundit atëherë e bën Federata Kombëtare e Bletërritësve të Shqipërisë, e cila përgatit një program monitorimi dhe parashikimi të kapacitetit nektaror dhe pjalmi, i cili miratohet nga ministri. Në program përfshihen edhe të dhëna për territorin, mënyrën e mbledhjes së të dhënave, kushtet dhe mënyrën e njoftimit të përdoruesve.

Struktura përgjegjëse në ministri, mban regjistrin për shfrytëzimin e kullotave mjaltëdhënëse. Kushtet e hollësishme për mbajtjen e regjistrit të kullotave mjaltëdhënëse, për mbarëshkrimin e tyre, lëvizjen, programi i parashikimit të kapacitetit nektaror dhe pjalmi, si dhe programi i shfrytëzimit, përcaktohen me udhëzim të ministrit, i cili u dërgohet bletërritësve përmes shoqatave lokale apo federatës.

#### ***Kreu IV, “Mbrojtja e Bletëve”, përbëhet nga 5 nene (përkatësisht nenet 12 – 16) dhe pasqyron:***

Detyrimet e bletarit në lidhje me mbrojtjen e bletëve, masat për parandalimin e dëmtimit të tyre, mbajtjen e regjistrit për trajtimet mjekësore. Masat profilaktike dhe luftimi i sëmundjeve të bletëve përcaktohen në fillim të çdo viti kalendarik për vitin vijues nga AKVMB, në bashkëpunim me ekspertët e fushës dhe Federatën Kombëtare të Bletërritësve të Shqipërisë (FKBSH), sipas legjislacionit përkatës.

Ndalohet trajtimi me produkte mjekësore veterinarë të cilat nuk lejohen për përdorim sipas legjislacionit përkatës dhe përdorimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe materialeve të tjera të cilat përmes produkteve të bletës mund ta dëmtojnë shëndetin e njeriut. Për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore (djegie, përmytje, dëmtime nga kafshët e egra, etj.), të nxiten bletarët të zbatojnë sigurimin vullnetar të aseteve të tyre; Raportimi i zgjojeve të bletëve dhe komunikimi i fillimit të aktivitetit, kushdo që ka koloni bletësh është i detyruar ta komunikojë pranë AKVMB-së, përfshirë edhe Shoqatat Lokale të Bletërritësve që veprojnë në zonë, duke specifikuar vendndodhjen dhe numrin e koshereve, brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe më pas, deri në fund të prillit, pas dimërimit të viteve në të cilat ka pasur një ndryshim në vendndodhjen ose numrin e zgjojeve në një përqindje të barabartë me të paktën 10 për qind.

Kushdo që ndërmerr veprimtarinë për herë të parë, kërkohet që:

- a. ta komunikojë atë sipas përcaktimeve të cituara;
- b. të ketë ndjekur një kurs kualifikimi, i cili në varësi të aktivitetit që do të ndërmarrë bletari i ri, përbëhet nga dy module: moduli bazë me rregullat e sigurimit teknik të sjelljes me kolonitë e bletëve, vendosjen e tyre në territor, bazat e mbarështimit dhe mjekimit, si dhe modulën e avancuar për bletarë profesionistë.

Modulët sipas përcaktimeve në projektakt, duhet të jenë të hartuara dhe të aprovuara nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, ose të jenë pjesë e kurrikulave të miratuara nga ministria përgjegjëse.

Raportet dhe komunikimet i adresohen shërbimeve veterinarë të AKVMB-së dhe përcillen tek struktura përgjegjëse dhe mosplotësimi i këtyre kushteve heq të drejtën e përfitimit përmes masave mbështetëse të sektorit. Asgjësimi i bletëve është i ndaluar përveçse në rastet e konfirmuara nga veterineri dhe të vërtetuara në mënyrë laboratorike nga laboratorët e akredituar, për prezencë të sëmundjeve ngjitëse të rrezikshme dhe bëhet në prezencë të inspektorëve veterinarë të AKVMB-së, zooteknikëve të AREB-ve, si dhe përfaqësuesve të Shoqatës Lokale të Bletërritësve, në mungesë do të jenë përfaqësuesit e federatës. Dëmshpërblimi i dëmeve për asgjësimin e bletëve, kryhet sipas përcaktimeve të ligjit “Për veterinarinë”.

Lidhur me përdorimin e produkteve të mbrojtjes së bimëve, në raste të domosdoshme të spërkatjes së bimëve, bletarët lajmërohen me të gjitha format e komunikimit, nga organet e pushtetit vendor, 3 (tre) ditë përpara, për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e bletëve, sipas akteve ligjore lidhur me PMB-të.

Pasi njoftohet bletari është i detyruar të ndërmarrë të gjitha masat mbrojtëse duke i mbyllur dyert e zgjojeve ose duke larguar parkun e bletëve së paku 6 (gjashtë) km larg në vijë ajrore nga zona e spërkatjes, nëse nuk i ndërmerr masat e nevojshme, nuk ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim nga askush për helmimin e bletëve. Për mbrojtjen e racës autoktone të bletëve kërkohet një mbrojtje e veçantë për racën vendase të bletëve *Apis Mellifera Carnica*, ku nxiten bletarët dhe institucionet e ndërlidhura të informojnë bletarët për përzgjedhjen e racës vendase, sipas përcaktimeve të ligjit “Për mbarëshkrimin e blegtorisë”, ndërsa për përzgjedhjen e llojeve të tjera të bletëve, duhet të konsiderohet përshtatja e llojit, sipas përcaktimeve të nenit 9, të këtij projektligji, ndaj kushteve lokale dhe rezistencën ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve, gjithmonë duke marrë miratim nga ministria, sipas legjislacionit përkatës për futjen e racave të reja në Republikën e Shqipërisë.

**Kreu V, “Bletaria Cilësore”, përbëhet nga 3 nene ( përkatësisht nenet 17 -19 ) dhe pasqyron:**

Bletaria biologjike, nënkupton se prodhimi biologjik i produkteve të bletës do të kryhet sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës për “Prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”; Skemat e cilësisë për produktet e bletës, për produktet e bletëve të prodhuara në vendin tonë me qëllim shtimin e vlerës dhe mbrojtjen e tyre me tregues cilësie: emërtim origjine të mbrojtur, tregues gjeografik të mbrojtur dhe specialitet tradicional të garantuar. Fermerët, shoqatat, grupet e prodhuesve, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, aplikojnë për skemat e cilësisë bazuar në legjislacionin përkatës “Për Skemat e Cilësisë së Produkteve Bujqësore dhe Ushqimore”; Etiketimi i produkteve të bletës bëhet në përshtatje me legjislacionin përkatës “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”, si edhe rregulloret përkatëse të produkteve. Elementët e etiketës janë:

- a. Emri ose emri tregtar dhe adresa e operatorit të biznesit ushqimor;
- b. Lista e përbërësve;
- c. Sasia e përbërësve ose e kategorive të caktuara të përbërësve sipas rendit zbritës;
- ç. Sasia neto e produktit ushqimor;
- d. Data e jetëgjatësisë minimale ose “të përdoret përpara datës...”, duhet të vendoset për produktet e bletës, e në rastin e mjaltit të vendoset “për një periudhë 24 mujore, nga data e prodhimit”;
- dh. Kushtet e veçanta të ruajtjes dhe/ose kushtet e përdorimit;
- e. Shteti i origjinës ose vendi i prejardhjes, sipas parashikime të legjislacionit;
- ë. Udhëzimet e përdorimit, kur në mungesë të tyre, përdorimi i duhur i produktit ushqimor do të ishte i vështirë;
- f. Deklarata e vlerave ushqyese;
- g. Përshkrimi, për mjaltin “Nuk rekomandohet për fëmijët nën 1-vjeç”.

Në rast të importit të mjaltit ose të produkteve të tij përveç elementëve të parashikuar më sipër etiketa duhet të përmbajë dhe përcaktimin që është produkt importi, shtetin nga vjen, si dhe duhet të jetë në gjuhën shqipe.

***Kreu VI, “Pjalnimi, Bletaria Urbane dhe Ushqyerja”, përbëhet nga 3 nene (përkatësisht nenet 20 -22 ) dhe pasqyron:***

Pjalnimi natyral, që njihet si veprimtari bujqësore dhe si e tillë është thelbësore për mbijetesën e njeriut sepse ndihmon në lehtësimin e prodhimit të ushqimit. Bletët janë pjalmuese efikase dhe të besueshme, janë mbledhëse metodike të nektarit dhe polenit, nuk shkatërrojnë bimën dhe ruajnë biodiversitetin dhe produktivitetin e ekosistemeve natyrore dhe bujqësore.

Meqenëse bletët pjalmojnë mbi 80% të bimëve të lulëzuara të tokës, përfshirë pothuajse të gjitha frutat dhe perimet, duhet të ndërmerren hapa për të rritur ndërgjegjësimin për nevojën e mbrojtjes së bletëve, pasi rënia e numrit të tyre mund të ketë një ndikim të paparashikueshëm në ekosistemet e tokës. Bletarët lejohen të blejnë, transportojnë dhe mbajnë sheqer dhe substanca të sheqerosura thelbësore për ushqimin e familjeve të bletëve, me detyrimin e mbajtjes së shënimeve të ngarkimit dhe shkarkimit të substancave me sheqer.

Bletaria urbane, duke qenë se bletët janë kampionues të shkëlqyeshëm të lëvizshëm dhe bioindikatorë të ndotjes kimike, pasi ato vijnë në kontakt me një sërë ndotësish gjatë fluturimeve të tyre të kërkimit të ushqimit, për efekt të monitorimit të mjedisit, mbajtja e bletëve mbi tarracat e pallateve në zonat urbane, rregullohet nga organet e qeverisjes vendore, përmes marrëveshjeve dypalëshe me Shoqatën Lokale të Bletërritësve, sipas legjislacionit në fuqi dhe përcaktimi i kushteve për mbajtjen e bletëve në mjediset urbane, miratohet me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe pushtetit vendor; ushqyerja e bletëve me sherbet/sheqer apo shurupë të tjerë, nuk duhet të bëhet gjatë periudhës së lulëzimit kryesor të bimëve mjaltëdhënëse dhe mbledhjes së nektarit nga bletë, ajo është e lejueshme gjatë lulëzimit të bimëve mjaltëdhënëse, vetëm në rastet e reshjeve të zgjatura të shiut (për disa ditë me radhë, që nuk lejojnë daljen e bletës për të grumbulluar nektar), dhe me njoftimin paraprak të veterinerit zyrtar (ku të deklarohet sheqeri i përdorur dhe sasia e përdorur, dhe të gjitha veprimet të jenë të pasqyruara në regjistrin e bletarit, me datën përkatëse).

Ushqimet e tjera të përdorura për të ushqyer bletët (me bazë proteinike apo sheqerore si candy, pogaçe, etj.) duhet të jenë të prodhuara vetëm nga stabilimente të licencuara dhe të kontrolluara nga autoritetet përkatëse të kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, çdo ushqim që është i pakontrolluar, mund të sjellë kontaminimin e paqëllimshëm të produkteve të bletës si p.sh. mjaltit, qumështit të bletës, etj., dhe shkakton prodhimin e produkteve jo në përputhje me kriteret e cilësisë.

***Kreu VII, “Mbështetja e Sektorit të Bletarisë”, përbëhet nga 1 nen (neni 23) dhe përcakton që:***

Për mbrojtjen e mjedisit dhe prodhimeve agropjore, hartohet një program për bashkërendimin e aktiviteteve për sektorin e bletarisë, në bashkëpunim me Shoqatat e Bujqësisë, Shoqatat e Bletërritësve në nivel lokal dhe Federatën e Bletërritësve në nivel kombëtar, shoqatat apo organizatat që mbështesin sektorin e bletarisë, si dhe me Organizatat në Mbrojtje të Konsumatorit.

Programi përmban udhëzimet për:

- promovimin dhe mbrojtjen e produkteve shqiptare të bletëve dhe nxitjen e proceseve të gjurmueshmërisë sipas legjislacionit përkatës, për mbrojtjen e mjaltit shqiptar;

- zgjerimin e produkteve me emërtim origjine të mbrojtur, tregues gjeografik të mbrojtur, specialitet tradicional të garantuar, si dhe produkt biologjik, sipas legjislacionit në fuqi;
- mbështetjen e shoqatave kombëtare ndërmjet bletërritësve dhe promovimin e marrëveshjeve profesionale;
- zhvillimin e programeve të kërkimit dhe eksperimentimit të bletarisë, në marrëveshje me shoqatat e bletërritësve, universiteteve, etj.;
- integrimin midis bletarisë dhe bujqësisë;
- vlerësimet e përgjithshme mbi kufijtë dhe ndalimet të cilave mund t'i nënshtrohen trajtimet me pesticide me produkte fitosanitare dhe herbicide toksike për bletët në kulturat e pemëve, barishtore, zbukuruese, të kultivuara dhe spontane gjatë periudhës së lulëzimit;
- përcaktimin e kufijve dhe ndalimeve për përdorimin e kulturave/bimëve mjaltëdhënëse që rrjedhin nga organizma të modifikuar gjenetikisht;
- nxitjen e praktikës së pjalmimit me anë të bletëve;
- nxitjen e praktikës së bletarisë dhe shtegtimit të bletëve;
- mbrojtjen dhe mbjelljen e kulturave të reja të bimëve mjaltëdhënëse, polendhënëse, apo nektaro-polenike sipas biodiversitetit;
- përcaktimin e ndërhyrjeve të rimëkëmbjes ekonomike dhe të kontrollit për luftën kundër *varrotozës* dhe sëmundjeve të tjera të bletëve;
- forcimin dhe zbatimin e kontrolleve mbi produktet e bletëve me origjinë kombëtare, BE, dhe jashtë BE-së;
- stimuj për të rinjtë për t'u vendosur dhe qëndruar në sektorin e bletarisë;
- sigurimin e mbështetjes për bletarët që operojnë në zona malore ose të pafavorizuara;
- mbrojtjen dhe përzgjedhjen e pastër të bletës shqiptare (*Apis mellifera carnica*) dhe racave të tjera të vendeve fqinje që janë përshtatur me kushtet e vendit tonë, sipas përcaktimeve të nenit 9, të këtij projektligji, si dhe nxitjen e prodhimit të mbretëreshave shqiptare nga qendrat e seleksionimit gjenetik.

Ky program miratohet me urdhër të përbashkët të MBZHR-së dhe ministrisë përgjegjëse për pyjet.

***Kreu VIII, "Përpunimi dhe Ruajtja e Mjaltit", përbëhet nga 3 nene (përkatësisht nenet 24 - 26) dhe pasqyron:***

Mjetet për prodhimin dhe përpunimin e mjaltit, përcakton se personi fizik/juridik që kryen procesin e prodhimit/përpunimit dhe ruajtjes së mjaltit duhet të zotërojë mjetet e mëposhtme:

- Për pranim, vjelje dhe mirëmbajtje të ambalazhit;
- Për përpunim, mbushje dhe paketim;
- Për prodhimet e paketuara;
- Për infrastrukturën.

Infrastruktura akomoduese e përpunimit dhe ruajtjes duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara në legjislacionin për ushqimin dhe rregullat e kontrollit HACCP, gjithashtu subjektet duhet të jenë të regjistruara në QKB, sipas legjislacionit të fushës, me objekt të veprimtarisë prodhimin/përpunimin dhe ruajtjen e mjaltit. Kushtet e ruajtjes: mjalti duhet të ruhet në vende të thata, të errëta, në temperaturë më të ulët se 25°C dhe lagështi relative të ajrit nga 65% deri në 80% ; mbikëqyrja do të kryhet nga inspektorët e veterinarisë dhe blegtorisë, sipas përcaktime ligjore.

***Kreu IX, "Kundërvajtjet Administrative, Masat dhe Ekzekutimi", përbëhet nga 5 nene (përkatësisht nenet 27 – 31) dhe përcakton që:***

Përbëjnë kundërvajtje administrative sipas përcaktimeve të këtij neni (neni 26) shkeljet e mëposhtme:

- a. Ushtrimi i veprimtarisë së bletarisë në kundërshtim me nenin 6, të këtij ligji;
- b. Moslajmërimi për numrin e shoqërive të bletëve sipas nenit 6, të këtij ligji;
- c. Mosrespektimi i distancës së vendosjes së parkut të bletëve sipas nenit 8, të këtij ligji;
- ç. Moszotërimi i certifikatës së gjendjes shëndetësore të bletëve në rastin e lëvizjes së tyre sipas nenit 9, të këtij ligji;
- d. Lëvizja e bletëve pa aprovimin e organit kompetent sipas nenit 9, të këtij ligji;
- dh. Transporti i bletëve në kundërshtim me nenin 9, të këtij ligji.

Mosnjoftimi i inspektorëve përkatës për dyshimin e paraqitjes së sëmundjeve me karakter përhapës sipas nenit 10, të këtij ligji.

Për kundërvajtjet e parashikuara më sipër, merren masat administrative përkatëse. Procedurat e kundërvajtjeve administrative të parashikuara në nenin 26 të këtij ligji, realizohen nga institucioni i kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, kundër vendimit të masës administrative bëhet ankim në Komisionin e Shqyrtimit të Masave Administrative në institucionin e kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i vendimit dhe kundër vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Masave Administrative në institucionin e kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë bëhet ankim në gjykatë brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga njoftimi i vendimit; ekzekutimi i vendimit bëhet nga institucioni i kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, i cili ekzekuton vendimin e formës së prerë të gjykatës në formën dhe parashikimet e legjislacionit në fuqi. Të ardhurat nga vjelja e gjobave kalojnë 100% në buxhetin e shtetit.

***KREU X, “Dispozita Kalimtare dhe të Fundit”, përbëhet nga 2 nene (nenet 32 dhe 33) dhe përcakton:***

Nxjerrjen e akteve nënligjore nga ministri, brenda 2 viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji; si dhe përcakton hyrjen në fuqi të këtij ligji, 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe fillimin e efekteve brenda 2 (dy) viteve nga botimi.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij projektligji janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB), Shoqatat Lokale të Bletërritësve, si dhe Federata.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektligj është hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e Ministrit nr. 543, datë 23.10.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e ligjit ‘Për bletarinë’ ” pjesë e të cilit kanë qenë përfaqësues nga Shoqatat Lokale të Bletërritësve, AKU, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Gjithashtu ky projektligj ka kaluar për konsultim me të gjithë ekspertët e fushës, përfshirë të gjitha Shoqatat Lokale të Bletërritësve, si dhe profesorë të fushës së Universitetit Bujqësor, komentet e të cilëve janë bërë pjesë e projektaktit.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji i propozuar nuk mbart efekte financiare për buxhetin e shtetit.

**MINISTËR**

  
**FRIDA KRIFCA**